



VIZITA E KRYEMINISTRIT KURTI NË AGJENCINË KADASTRALE TË KOSOVËS

Në muajin prill të këtij viti Kryeministri Albin Kurti bashkë me Ministrin e MMPHI Liburn Aliu kanë vizituar Agjencinë Kadastrale të Kosovës. Ata u pritën nga Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së Avni Ahmeti me bashkëpunëtorë, ku u njoftuan nga afër me projektet, punët, aktivitetet dhe planifikimet e mëtutjeshme të AKK-së. Pas prezantimit të punës nga ana e udhëheqësisë së AKK-së, Kryeministri Kurti në fjalën e tij ka premtuar mbështetje për këtë institucion specifikisht për Ligjin perkadastër, aktivitetet e projektit të Bankës Botërore, funksionalizimin e Zyreve Kadastrale Komunale në 3 Komunat Veriore, etj. “Digjitalizimi ka përshpejtuar punën e kadastrës, pritët që në digjitalizim të ri të kemi një aerofotografim të ri të territorit

të Kosovës. Kadastra për një shtet është pasqyra që e shohim vetën. Krijimi i kushteve të punës për Agjencinë është i nevojshëm. Objekti i ri i AKK-së 4 mijë metra katror dhe kushton 2.1 milionë euro”, tha Kryeministri Kurti. Vlen të theksohet që Agjencia Kadastrale e Kosovës për herë të parë vizitohet nga një kryeministër dhe se kjo vizitë do të jetë mbështetje dhe motiv shtesë për punë në këtë institucion. Pas takimit në AKK kryeministri Kurti së bashku me ministrin e MMPHI-së Liburn Aliu dhe Zv. Drejtorin e përgjithshëm të AKK-së Avni Ahmeti, kanë vendosur gurëthemelin për objektin e ri të AKK-së, i cili do të ndërtohet në rrugën “Nekibe Kelmendi”, te Pallati i Drejtësisë. Ministri Liburn Aliu u shpreh:

“Uroj që objektin për të cilin do ta vendosim sot gurëthemelin të na krijoj kushte me të lehta në fushën e kadastrës. Ndërtimi i tij nuk është punë e lehtë, do të punojmë që të kemi një kadastrë me punë sa më të lehtë. Në gjitha komuna e vërejmë që ka probleme me kadastrë; digjitalizimi është një pjesë që e lehtëson këtë punë. Projekti i radhës që është aerofotografimi me një cilësi të larët do të mundësojë projekte të reja. Si ministri i kemi bërë disa harta”.



KORNIZA LIGJORE



PROJEKTLIGJI PËR KADASTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e 145-të të mbajtur me datë 7 qershor 2023, ka miratuar Projektligjin për Kadastër të Pronës së Paluajtshme. Ky projektligj do të shënojë reformë rrënjësore në sektorin e kadastrit dhe do të avancojë më tutje sistemin kadastral në Republikën e Kosovës. Fokusi i reformave që parashihet të arrihen me këtë ligj është:

- Unifikimi i legjislacionit nga fusha e kadastrës;
- Organizimi vertikal institucional përmes përfshirjes së Zyrave Kadastrale Komunale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, me qëllim të rritjes së performancës, përgjegjësisë në punë, bashkëpunimit dhe koordinimit më të mirë.
- AKK-ja synon të adaptojë këtë praktikë të mirë bazuar edhe në sistemin

kadastral të shteteve të rajonit dhe më gjerë;

- Fuqizimi i rolit të komisionit për Rindërtimin e informacioneve kadastrale, me qëllim të mundësimin të regjistrimit të pronave, më shpejt dhe më lirë, në emër të pronarëve faktik si dhe zvogëlimin të informalitetit i cili është barrë për të drejtat pronësore në Republikën e Kosovës;
- Karakteri publik i të dhënave kadastrale, përkatësisht qasja më e lehtë e institucioneve dhe publikut në informacione kadastrale.

Miratimi i Projektligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, është një hap drejt arritjes së objektivave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës të cekura më lart, por pa u kufizuar vetëm në to, me qëllim avancimin dhe modernizimin e kadastrit, shërbime më të mira e më të shpejta, transparencë dhe efikasitet në punë. Në javët e fundit zyrtarët e AKK-së kanë mbajtur disa takime me grupin punues të Komisionit Parlamentar për Mjedis,

Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, ku janë adresuar të gjitha komentet e dhëna për Projektligjin për Kadastër të Pronës së Paluajtshme

HARTIMI I UDHËZIMEVE ADMINISTRATIVE PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR KADASTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Për implementim të Ligjit për Kadastër të Pronës së Paluajtshme janë paraparë të nevojshme 14 Udhëzime administrative. Me dt. 14.09.2023 është formuar Grupi i brendshëm punues për hartimin e drafteve të 14 projekt Udhëzimeve Administrative për zbatimin e Ligjit për kadastër të pronës së paluajtshme. Grupi punues deri më tani kanë hartuar draftet fillestare të 10 projekt Udhëzimeve Administrative dhe finalizimi i tyre duhet të bëhet deri me dt.30.10.2023. Gjatë këtij muaji ky grup ka punuar intenzivisht në finalizimin e UA me qëllim që të mos ketë vonesa në implementim të ligjit me prioritet ato që lidhen me aktivitetet në kuadër të projektit REGIP të Bankës Botërore.



HARTIMI I UDHËZIMEVE ADMINISTRATIVE PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 08/L-010 PËR KRIJIMIN E INFRASTRUKTURËS KOMBËTARE TË INFORMACIONIT HAPËSINOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturrës Kombëtare të Informacionit Hapësinor në Republikën e Kosovës, AKK-ja ka krijuar Grupin e brendshëm punues me datë 23.03.2023. Ndërsa Grupet punuese me vendim të Sekretarit janë formuar me datë 12.05.2023. Këto Udhëzime Administrative janë nënshkruar nga Ministri me datë 28.08.2023.


HARTIMI I STRATEGJISË PËR INFRASTRUKTURË KOMBËTARE TË INFORMACIONIT HAPËSINOR

Bazuar në Ligji Nr. 08/L-010 për Krijimin e Infrastrukturrës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH), Strategjinë

e IKIH-së e harton Agjencia Kadastrale e Kosovës. Ky aktivitet është realizuar me mbështetjen e projektit REGIP të Bankës Botërore përmes konsulentit individual Frank Haugan. Në kuadër të kësaj Strategjie me datë 4 dhe 5 shtator është mbajtur trajnimi për stafin e AKK-së në temat: qeverisja dhe çështjet ligjore të IKIH-së, të dhënat hapësinore dhe standardet, çështjet financiare, politikat, inovacioni dhe partneriteti për IKIH, si dhe

me datë 6 dhe 7 shtator punëtori me akteret e IKIH-së në Kosovë

në temat: Metodologjia e IGIF duke u fokusuar në vlerësimin bazë dhe Kontrolli i cilësisë së të dhënave hapësinore. Gjatë kësaj punëtorie është prezantuar edhe draft Strategjia e IKIH-së si dhe shtojcat e saj. Kjo strategji është përfunduar me 15 tetor 2023 dhe pritet të aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës deri në fund të vitit 2023.



QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
APROVON PROJEKTLIGJIN PËR
KADASTËR TË PRONËS SË
PALUAJTSHME



- ✓ Unifikim i legjislacionit nga fusha e kadastrit.
- ✓ Organizim vertikal institucional përmes përfshirjes së Zyrave Kadastrale Komunale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës.
- ✓ Fuqizim i rolit të komisionit për Rindërtimin e Informacioneve Kadastrale.
- ✓ Qasje më e lehtë e institucioneve dhe qytetarëve në informacione kadastrale.

PROJEKTET KAPITALE



AEROFOTOGRAFIMI I TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Një projekt i një rëndësie të veçantë për vendin, Rilevimi Aerofotogrametrik i Territorit të Republikës së Kosovës po zhvillohet nga Agjencia Kadastrale e Kosovës. Bazuar në planin dinamik, në këtë periudhë kohore është planifikuar të fillojë sinjalizimi i pikave kontrolluese në terren për blloqet urbane dhe rurale të cilat bazuar nga monitorimet e AKK-së plotësojnë standartet dhe saktësinë e kërkuar. Ky projekt ka filluar me 06.07.2023 dhe do të plotësojë nevojat e qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme të Republikës së Kosovës për fusha të ndryshme që ato mbulojnë, si: Agjencisë Kadastrale të Kosovës, për çështje kadastrale, hartografike, sistemit të adresave, etj, Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, për planifikim urbanistik, infrastrukturën rrugore, menaxhimin e ujerave etj, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

për menaxhimin e pyjeve, tokave bujqësore etj, Ministrisë së Financave, Departamentit të Tatimit në Pronë, etj, Ministrisë së Punëve të Brendshme, përkatësisht Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave për fatkeqësitë natyrore, etj, Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare, etj, Ministrisë së Mbrojtjes FSK-së për veprimtaritë ushtarake, etj. Projekti është planifikuar të implementohet në 2024.

Rezolucioni i ortofotove do të jetë:

- Në Zonën Urbane **8cm** sipërfaqe **1026km²**
- Në Zonën Rurale **15cm** sipërfaqe **10134km²**

Në kuadër të projektit, do të krijohet edhe modeli digjital i sipërfaqes (DSM) si dhe modeli digjital i terrenit (DTM), si në zonat rurale ashtu edhe ato urbane.

Gjithashtu në kuadër të këtij projekti do të krijohet modeli 3D i objekteve në dy lokacione të ndryshme, në zone urbane dhe në zone rurale. Rezultatet e arritura nga krijimi i modelit 3D, do të shërbejnë për definimin



e standardeve dhe specifikave për të ngritur të gjitha objektet e territorit të Republikës së Kosovës në modelin 3D në projektin e ardhshëm.

ZHVILLIMI I PROJEKTIT TË RRJETIT TË NIVELIT DHE SISTEMI REFERENT I LARTËSIVE

Një ndër komponentët më të rëndësishme dhe të domosdoshme për përfundimin dhe përcaktimin të Sistemit Referent të Lartësive, krahas rrjetit referent GNSS dhe Rrjetit Gravimetrik është zhvillimi i rrjetit të nivelimit në Republikën e Kosovës.

Andaj, objektivi është kompletimi i rrjetit të nivelimit si bazë e domosdoshme për nevoja tona por edhe fakti që si shtet mos të mbesim prapa në zhvillimet regjionale në këtë fushë, pasi që shumica e shteteve të regjionit veq e kanë kompletuar këtë aktivitet.

Me këtë projekt kompletohen Rrjetat gjeodezike në territorin e Republikës së Kosovës. Të dhënat nga rrjeti i nivelimit do të shërbejnë



për matje të precizitetit të lartë. Gjatësia e vijës së nivelimit të precizitetit të lartë është 800 km, në kuadër të së cilës vijë do të stabilizohen: 5 pika themelore, 50 pika nyje dhe 350 pika të zakonshme.

MBLEDHJA DHE PËRDITËSIMI I TË DHËNAVE TË ADRESAVE PËR TERRITORIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Përgjegjësinë ligjore për krijimin e Sistemit të Unifikuar të Adresave, AKK e ka marrë në vitin 2012. Për mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave të adresave për territorin e Republikës së Kosovës, janë nënshkruar kontrata me 52 punonjës për të përkrahur komunat që këto të dhëna të jenë të përditësuara në Sistemin e Adresave (ARIS).

Deri tani puna ka përfunduar në 29 komuna 100%, në 3 komuna 30% dhe 6 komuna (4 Komuna Veriore, Shtërpçë dhe Ranillug) nuk ka filluar akoma në përditësimin e të dhënave. Ky projekt pritet të përfundohet deri në fund të vitit 2023.

MATJA E RRUGËVE TË REJA DHE PËRDITËSIMI I TYRE NË SISTEMIN E REGJISTRIT TË ADRESAVE ARIS

Në kuadër të projektit REGIP të Bankës Botërore, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka paraparë edhe komponentën për kompletimin e Sistemit të Adresave në Republikën e Kosovës. Në kuadër të këtij komponenti janë paraparë disa aktivitetet si: Matja e rrugëve të reja në teren, mbledhja

dhe përditësimi i të dhënave të adresave, prodhimi dhe instalimi i tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të adresave për komunat e ku mungojnë, ndërlidhja e qytetarëve me Adresa zyrtare dhe zhvillimi i aplikacionit ARIS mobile.

Aktiviteti për matjen e rrugëve të reja në teren ka përfunduar me sukses. Ky aktivitet ka filluar në maj të vitit 2023 dhe ka përfunduar në gusht të vitit 2023. Ky aktivitet ka pasur për qëllim matjen e rrugëve të reja të cilat kanë qenë të skicuara paraprakisht nga ana e komunave dhe më pastaj përmes GPS është bërë matja e rrugëve. Gjatësia e rrugëve të skicuara nga komunat ka qenë rreth 635628 metra, kurse rrugë të matura në fund të projektit ishin rreth 797165 metra.

Ky aktivitet ka qenë shumë i rëndësishëm për faktin që komunave iu është dhënë mundësia që të dhënat e adresave të jenë sa më të përditësuara. Përditësimi i të dhënave të adresave është shumë i rëndësishëm për faktin që Sistemi paraqet një gjendje më reale për numrin e tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të adresave që kanë nevojë për prodhim dhe instalim, e më pastaj është i rëndësishëm edhe për pajisjen e qytetarëve me adresë zyrtare.



VENDOSJA E TABELAVE TË EMRAVE TË RRUGËVE DHE NUMRAVE TË OBJEKTEVE PËR KOMUNAT E MBETURA TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Me projektin për vendosjen e tabelave të emrave të rrugëve dhe numrave të objekteve për komunat e mbetura të Republikës së Kosovës është paraparë që tabelat e emrave të rrugëve të vendosen në 4 komuna me gjithësej 1.500 emra. Tabelat e numrave të objekteve do të vendosen në 22 komuna me gjithësej 320.000 numra.



LIDHJA E SISTEMIT TË ADRESAVE ME REGJISTRIN CIVIL

Me iniciativë të Zyrës së Kryeministrit dhe me mbështetje të GIZ-it, është zhvilluar pilot projekti për lidhjen e Sistemit të Adresave me Regjistrin civil në Komunat Mitrovicë e Jugut dhe Istog.

Në këtë pilot projekt janë planifikuar të realizohen:

- Pilot projekti në Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe Istogut;
- Pilot projekti i mbështetur nga GIZ-I Gjerman;
- Projekti për komunat e mbetura mbështetur nga Banka Botërore;
- Krijimi i Sistemit SELQA (Sistemi Elektronik për Lidhjen e Qytetarit me Adresë);

- Kontrollimi dhe aprovimi i të dhënave;
- Ndërlidhja e Qytetarit me Adresë përmes aplikacionit SELQA;
- • Angazhimi i stafit për ndërlidhjen e qytetarit me adresë në teren;
- Përditësimi i Sistemit të Gjendjes Civile me adresat zyrtare;
- Shpërndarja e të dhënave tek institucionet tjera (rreth 58);
- Kushtëzimi i shërbimeve nga ARC me adresë zyrtare.
- Me realizimin e këtij projekti janë arritur rezultatet:
- Krijimi i aplikacionit SELQA (desktop dhe për tableta) i hostuar në ARC;
- Në komunën e Istogut janë regjistruar rreth 10,300 adresa prej 13,300
- Në komunën e Mitrovicës së Jugut janë regjistruar rreth 10,600 nga rreth 21,000 adresa.
- Përfitimi nga procesi i ndërlidhjes regjistrat civil me regjistrin e adresave:
- Mundëson pajisjen e qytetarëve me adresë zyrtare dhe unike;
- Është rekomandim i BE-së në kuadër të reformës zgjedhore në kuadër të ERA2;
- Mundëson përdorimin e adresës zyrtare dhe unike nga të gjithë regjistrat shtetëror;
- Mundëson pastrimin e listave të votuesve dhe zvogëlimin e distancës për të votuar;
- Mundëson të dhënat e sakta rreth migrimit të brendshëm;
- Lehtëson Regjistrimin e Popullsisë;
- Mundëson zonimin e QKMF/ QMF/AMF;
- Mundëson zonimin e institucioneve shkollore publike të nivelit të ulët;
- Mundëson përdorimin e adresës zyrtare dhe unike në të gjitha faturat e shërbimeve publike (KEDS, Ujësjiellës, shërbimeve të pastrimit etj.);
- Mundëson gjetjen e lokacionet më të shpejt nga Policia;
- • Mundëson gjetjen e lokacionit për emergjencë nga AME;
- • Lehtëson navigimin në teren
- • Mundëson shpërndarjen më të lehtë dhe më të shpejtë të dërgesave nga Posta.



KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI NDËR INSTITUCIONAL



TAKIMI I PARË I KOMITETIT NDËRMINISTROR PËR ADMINISTRIM TË TOKËS DHE INFRASTRUKTURË KOMBËTARE TË INFORMACIONEVE HAPËSINORE

Me datë 1 qershor 2023, ka filluar zyrtarisht punimet në takimin e parë koordinues, Komiteti për Administrimin e Tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacionin Hapësinor (IKIH) në Republikën e Kosovës.

Anëtarët e Komitetit janë caktuar mbi bazën e vendimit të Qeverisë së datës 24.08.2022 Nr.10/94. Anëtarë të Komitetit, janë përfaqësuesit e institucioneve nga ministritë e linjës në Republikën e Kosovës, si dhe përfaqësues nga Agjencitë Ekzekutive të Pavarura,

të përcaktuara sipas vendimit qeveritar. Komiteti Ndërmintor, kryesohet nga Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z. Liburn Aliu. Në hapje të punimeve të Komitetit, në fjalën e tij hyrëse ministri Aliu tha që Administrimi i tokës dhe i informacionit mbi tokën, realizohet përmes një sistemi funksional të gjeoinformacionit dhe informacionit hapësinor në tërë territorin e vendit, për të mundësuar planifikimin adekuat hapësinor si komponentë kyç në cilësinë dhe kushtet e jetesës, dhe matjes së progresit shoqëror të një vendi të zhvilluar demokratik. Tutje ai, përmendi rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit të Komitetit për funksionimin e plotë të tij në përputhje me mandatin ligjor. Zv. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kadastrale të Kosovës- z. Avni Ahmeti, në fjalën e tij tha që Republika

e Kosovës, është duke e implementuar një infrastrukturë moderne të Administrimit të Tokës, dhe po ndjekë praktikat më të mira të vendeve anëtare në Bashkimin Evropian. Komiteti, do të ushtroj veprimtarinë e tij në fushat e rëndësishme si: identifikimi i politikave dhe çështjeve strategjike, ofrimin e propozimeve të reja lidhur me politikat e administrimit të tokës dhe Infrastrukturën Kombëtare për Informacion Hapësinor, si dhe koordinimin dhe monitorimin e të gjitha iniciativave brenda fushës së administrimit të tokës dhe IKIH-së. Anëtarët e Komitetit, dhe të pranishmit e tjerë vazhduan punimet duke shqyrtuar draft rregulloren e punës së komitetit, draft Strategjinë Kombëtare për Informacion Hapësinor, dhe kornizën ligjore rregullative për IKIH. Në takim të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Bankës Botërore, USAID-

Aktiviteti i Qeverisjes së Pronës, JICA, GIZ, OSCE, dhe Dutch Kadaster.

TAKIMI KOORDINUES NDËRINSTITUCIONAL ME KRYETARËT E KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Të pranishëm në takimin e parë koordinues ndërinstitucional ishin kryetarët e komunave, nënkryetarët dhe drejtorët e drejtorive të kadastrit në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z. Liburn Aliu, përfaqësues të zyrës së USAID, përfaqësues të nivelit lokal, dhe media të ndryshme. Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Liburn Aliu, në fjalën e tij, përmendi zhvillimet, planet dhe objektivat në fushën e kadastrit, pronës dhe infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në vend. Tutje ai tha që, administrimi i tokës, sistemi efikas i kadastrit, ofrimi i shërbimeve publike kadastrale për qytetarët e vendit përmes qasjes e trajtimit të barabartë, si dhe zhvillimi

i infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor, përbëjnë thelbin e orientimit të politikave të sektorit të planifikimit hapësinor, infrastrukturës dhe mjedisit.

“Administrimi i tokës dhe i informacionit mbi tokën, realizohet përmes një sistemi funksional kadastral në tërë territorin e vendit, për të mundësuar ndërtimin dhe banimin adekuat si komponentë të rëndësishme të kualitetit të jetesës, dhe mirëqenies shoqërore. Si Ministri e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, edhe më tej do të angazhohemi maksimalisht në ofrimin e mbështetjes së plotë për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, për realizimin e reformave në kadastrin shtetëror, ngritjen e kapaciteteve për nivelin lokal, si dhe sigurimin e shërbimeve publike kualitative dhe efikase për qytetarët tanë” u shpreh ministri Aliu. Z. Sokol Haliti nga Asociacioni i Komunave të Komunave të Kosovës, në fjalën e tij tha që, ky takim sot do të shërbejë, si mesazh për ngritjen e vetëdijes mbi llogaridhënien publike që të gjithë e kemi karshi votuesve dhe qytetarëve të komunave të cilat i përfaqësojmë, si dhe obligimin ligjor e moral ndaj përmirësimit të qeverisjes së drejtë e demokratike.

Zv. Drejtori i Përgjithshëm i AKK-së, z. Avni Ahmeti, përmendi para të pranishmëve projektet më të rëndësishme të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, duke përfshirë këtu: projektet e Bankës Botërore, RIK, kompletimi i sistemit të adresave, avancimi i sistemeve kadastrale, rindërtimi i informacioneve kadastrale, si dhe korrektimi i të dhënave për persona. Z. Ahmeti tha që Agjencia Kadastrale e Kosovës, ka identifikuar të gjitha problemet në fushën dhe sektorët që mbulon, duke ofruar zgjidhje për secilën prej tyre. Tutje, ai theksoi rëndësinë e përkrahjes institucionale në nivelin qendror dhe lokal për të bërë ndryshimet e nevojshme.

TAKIMET KOORDINUESE TË DONATORËVE ME QËLLIM TË KOORDINIMIT TË AKTIVITETEVE TË ASISTENCËS FINANCIARE E ZHVILLIMORE PËR ADMINISTRIMIN E TOKËS NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Në gjashtëmujorin e fundit AKK-ja ka mbajtur dy takime koordinuese me donatorë me qëllim të koordinimit të aktiviteteve të asistencës financiare e zhvillimore për administrimin e tokës në Republikën e Kosovës. Të pranishëm në këto takime ishin përfaqësues nga Banka Botërore, USAID- Aktiviteti Qeverisja e Pronës, Zyra Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar-JICA, OSBE, GIZ dhe UN Habitat. Pjesëmarrësit në takim diskutuan mbi fazat aktuale dhe





ato të ardhme lidhur me aktivitetet në fushën e kadastrit, programet ekzistuese dhe programet e reja të financimit, të cilat kanë për qëllim avancimin dhe përmirësimin e sektorëve të rëndësishëm në fushën e kadastrit. Takimet me donatorë do të ndihmojnë Agjencinë Kadastrale të Kosovës në planifikimin e aktiviteteve të rëndësishme, të cilat do të jenë të koncentruara në përmirësimin e sistemit kadastral, përmirësimin e infrastrukturës si dhe në mbështetje e financim të projekteve kapitale në Republikën e Kosovës.

KOMITETI PËR PRAKTIKA TË MIRA PËR BASHKËPUNIM NDËR INSTITUCIONAL I PËRKRAHUR NGA PROJEKTI I USAID-IT PËR QEVERISJE PRONËSORE

Në kuadër të Aktivitetit për Qeverisje Pronësore, Agjencia Kadastrale të Kosovës në bashkëpunim me USAID-in kanë organizuar disa takime të Komitetit të praktikave të mira me pjesëmarrës zyrtarë nga komunat e: Pejës, Ferizajit, Lipjanit, Suharekës, Rahovecit, Obiliqit, Mitrovicës së Jugut, Gjakovës, Prizrenit, Gjilanit dhe Prishtinës. Pjesëmarrës ishin gjithashtu edhe zyrtarë nga Zyra e

Kryeministrit, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë

dhe Infrastrukturës, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë. Tema të ndryshme diskutimi u trajtuan në këto takime duke përfshirë: “Ndryshimet ligjore në legjislacion në lidhje me ankesat kundër vendimeve të ZKK-së dhe AKK-së” dhe Programi Qeveritar për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027 (me fokus në shërbimet kadastrale), Raportet nga monitorimet e punëve dhe aktiviteteve të ZKK-ve përkatëse pjesë e këtij programi, etj. Komiteti i Praktikave të Mira (KPM) shërben si një forum këshillues ndër-institucional, për shkëmbimin e përvojave, praktikave më të mira dhe mësimet të nxjerra ndërmjet institucioneve të nivelit lokal dhe qendror, që kanë një rol të drejtpërdrejtë në qeverisjen dhe mirëmbajtjen e Regjistratit të Drejtave Pronësore në Kosovë. Nga këto takime synohet që të definohen hapat që duhet të ndërmarrë secila ZKK në drejtim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarë, mënyrën e riorganizimit dhe ndryshimeve në staf, e pozita mbrenda ZKK-së dhe rekomandime të tjera që lidhen me përsheptimin e punëve.

VENDOSJA E SHËNIMIT NGA ANA E NOTERËVE DHE PËRMBARUESVE NË SIKTK T

Me datë 03.06.2023 Agjencia Kadastrale e Kosovës ka mbajtur trajnim për të gjithë noterët e Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi nga afër me hapat që noterët duhet të ndjekin në Sistemin e shërbimeve digjitale të AKK-së, për regjistrimin e shënimit për njësitë kadastrale që do të jenë objekt i akteve noteriale. Vendosja e këtij shënimi në regjistrin e të drejtave pronësore do të ngrisë nivelin e sigurisë së transaksioneve dhe do të ndihmojë në parandalimin e krijimit të dy ose më tepër akteve noteriale për njësitë e njejta kadastrale. Një zhvillim i tillë është mundësuar edhe për Përmbaruesit privat, të cilët janë trajnuar nga AKK-ja javën e kaluar, për regjistrimin e shënimit për Urdhër pëmbarimorë. Meqë fokusi i AKK-së do të jetë digjitalizimi i shërbimeve kadastrale, noterët poashtu u njoftuan edhe me angazhimin e institucionit tonë për të zhvilluar modulën e ri nëpërmjet të cilit regjistrimi i të drejtave pronësore në regjistrat do të bëhet nga ana e noterëve. Nga data e fillimit të regjistrimit të këtyre shënimeve nga ana e Noterëve kanë kaluar afërsisht 3 muaj dhe për këtë periudhë kohore janë regjistruar mbi 10270 shënime, që do të thotë janë siguruar 10270 njësi kadastrale pjesë e transaksioneve pronësore. Në të njejtën formë mendohet në të ardhmen e afërt ti jepet qasje edhe institucioneve tjera si Gjykatave, Prokurorisë etj.,



SHOQATA E GJEODETËVE NË MBËSHTETJE TË PUNËVE DHE AKTIVITETEVE TË AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

Në një takim të përbashkët informues për punët, projektet dhe aktivitetet e saj, AKK-ja ka pritur në takim Shoqatën e gjeodetëve dhe gjeodetët e licencuar. Në takim u prezentuan nismat e AKK-së për reforma ligjore (përfshirë Projektligjin e kadastrit, i aprovuar në Qeveri), projektet e planifikuara për tu realizuar dhe fillimi i monitorimit të gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara. Në veçanti u prezentua Moduli i gjeodetëve i cili do të iu ofrojë

qasje më të lehtë dhe më të shpejtë gjeodetëve në regjistra kadastral, përfshirë edhe azhurnimin e të dhënave në pjesën grafike dhe tekstuale nga vet ata. U prezentuan poashtu edhe risitë e fundit në procesin e digjitalizimit të shërbimeve kadastrale dhe ofrimin e informacioneve në kohë reale për qytetarë. Gjeodetët vlerësuan punën e AKK-së gjithashtu falemnderuan AKK-në për hapsirën e ofruar për ta për të kontribuar në ngritje të mëtejme të cilësisë së shërbimeve kadastrale dhe u zotuan për vazhdimin e bashkëpunimit të mirë që kanë me AKK-në. E AKK-ja në anën tjetër kërkoi bashkëpunim dhe përkrahje edhe nga ana e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara, në nismat e saja më qëllimin e përbashkët të të dyja palëve ngritjen e mëtejme të nivelit të shërbimeve kadastrale.

PËRKRAHJE NË AZHURNIMIN E PARCELAVE TË SHPRONËSUARA NË REGJISTRIN E TË DREJTAVE MBI PRONËN E PALUAJTSHME

AKK-ja deri tani ka përkrahur disa institucione në azhurnimin e parcelave të shpronësuara në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme si: Ministrinë e Mbrojtjes, Shëndetësisë, Kulturës, Punëve të Brendshme, Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucioneve tjera. Përgatitja e elaboreteve të shpronësimit për institucione të ndryshme, aktivitet ky i cili i ka hapur rrugën investimeve dhe donacioneve të ndryshme vendore e ndërkombëtare.



AKTIVITET TJERA TË AKK-SË



AVANCIMI I SHËRBIMEVE KADASTRALE PËR QYTETARË

- Është zhvilluar dhe publikuar aplikacioni për gjurmimin e lëndëve 24/7 nga qytetarët që kërkojnë shërbime kadastrale, pra secila palë në çdo kohë mund të merr informacion mbi statusin e lëndës,
- Është zhvilluar dhe publikuar avancimi në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK) me titull “trajtimi i kërkesave sipas radhës”, pra kush aplikon i pari do të shërbehet i pari
- Janë shtuar qasje për qytetarë e-Kioska për pajisje me Certifikatë pronësie në Komunitet: Podujevë, Obiliq, Pejë dhe Klinë,
- Është implementuar komunikimi digjital për regjistrimin dhe fshirjen e barrave tatimore nga ATK në regjistrin e të dhënave kadastrale,

SHFUQIZIMI I RREGULLORES PËR PEZULLIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE PËR MBLEDHJEN E DETYRIMEVE TË PAPAGUARA TË TATIMIT NË PRONË

Është shfuqizuar Rregullorja (QRK) Nr. 07/2021, mbi Pezullimin e Shërbimeve Komunale për Mbledhjen e Detyrimeve të Papaguara të Tatimit në Pronë. Pra, duke filluar nga ky muaj, Zyret Kadastrale Komunale më nuk duhet të kërkojnë vërtetimin për pagesën e tatimit në pronë, për të gjitha shërbimet kadastrale. Edhe ky aktivitet është pjesë e punës intensive që AKK-ja po realizon këtë vit me qëllim të thjeshtësimit të procedurave administrative, reformimin ligjor dhe digjitalizimin e shërbimeve. Kjo çështje ka qenë njëra nga temat e Komitetit për praktika të mira i udhëhequr nga Agjencia Kadastrale dhe i përkrahur nga USAID. Kujtojmë që para disa muajsh në platformën eKosova janë publikuar edhe mundësitë e aplikimit të

qytetarëve për certifikata pronësie, kopje plani dhe koordinata të njësive kadastrale duke ndikuar direkt në rritjen e knaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet kadastrale.

MONITORIMI I PUNËVE DHE AKTIVITETEVE KADASTRALE TË ZYRAVE KADASTRALE KOMUNALE DHE SEKTORIT PRIVAT TË GJEODETEVE TË LICENCUAR

Shërbimet dhe punët kadastrale duhet të kryhen sipas kriterëve të larta të kualitetit, bazuar në ligj, udhëzime administrative, korniza, doracakë, etj të cilët përcaktojnë mënyrën e realizimit të këtyre shërbimeve. Matjet precize, kualiteti i lartë gjatë grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave kadastrale nga terreni duhet të bëhen në përpurthje me Kornizën e punës së AKK-së. Zv. Drejtori i përgjithshëm i AKK-së me vendim ka caktuar anëtarët e grupit monitorues me qëllim të monitorimit të aktiviteteve të kryera nga gjeodetët. Grupi monitorues është duke vazhduar me ritëm të intensifikuar të monitorojë të gjitha punët në terren. Deri tani është realizuar monitorimi i 11 ZKK-ve, 17 gjeodetëve të licencuar dhe 1 kompanie gjeodezike të licencuar.



TRAJNIMI DHE TESTIMI I KANDIDATËVE PËR LICENCIM SI GJEODET SI DHE ZYRTARËVE TË ZKK-VE



Pas një trajnimi njëditorë për kandidatët aplikues për licencim, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka mbajtur testimin elektronik për licencimin e gjeodetëve të rinjë, dhe ri licencimin e gjeodetëve të cilët kanë ushtruar veprimtarinë e tyre më parë në ofrimin e shërbimeve kadastrale.

Testi për Licencim përmban materien që rregullon fushën e kadastrit dhe regjistrimit të të drejtave sendore në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu Agjencia Kadastrale e Kosovës ofron përkrahje e mbështetje të vazhdueshme profesionale për zyrtarët e ZKK-ve në qasjen dhe shfrytëzimin e aplikacioneve digjitale, për ofrimin e shërbimeve kadastrale për qytetarët e vendit.

Zyrtarë të Zyrave Kadastrale Komunale janë trajnuar për shfrytëzimin e SIKTK-së. Ata janë njoftuar për së afërmi me funksionet e sistemit për regjistrimin, përpunimin dhe aprovimin e lëndëve për mirëmbajtje të rregullt të të dhënave kadastrale.



AKTIVITETE TJERA

- ✓ Është përgatitur raporti informues dhe plani i veprimit mbi aktivitetet e realizuara dhe planifikuara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për komunat Mitrovica Veriore, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok,
- ✓ Është bërë fshirja e hipotekave të skaduar nga sistemi SIKTK,
- ✓ Është duke u bërë korrektimi/unifikimi i personave fizik dhe juridik në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK)- pjesa tekstuale,
- ✓ Pjesëmarrje në Kolegjin e Drejtoreve të Planifikimit Hapësinorë në kuadër Asociacionit të Komunave të Kosovës të organizuar nga UN-Habitat,
- ✓ Hartimi i draftit të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AKK,
- ✓ Fillimi i korrektimit/unifikimit të personave fizik dhe juridik në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë- pjesa tekstuale,
- ✓ Takim në MMPHI për të diskutuar dhe zgjidhur problemet në elaboratin e shpronësimit për projektin e rrugës Prishtinë – Podujevë,
- ✓ Pjesëmarrje në puntorinë tri ditore të organizuar nga komisioni për legjislacion i Kuvendit të Kosovës për Projektligjin nr. 08/L-064 për Tokën Ndërtimore,
- ✓ Përgaditja e elabtrateve të shpronësimit për katër deponi sipas “Programit për Menaxhimin e Mbeturave të Ngurta II-IV,
- ✓ Mbajtja e takimit me Odën e Ndërmjetësuesve dhe USAID për të diskutuar për problemet, sfidat dhe aktivitetet në të ardhmen,
- ✓ Janë hartuar dhe aprovuar drafti i Specifikave Teknike për:
 - 1) Zhvillimin e moduleve të reja në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK),
 - 2) Korrektimin e të dhënave në Sistemin e Informacionit Kadastral për Tokën në Kosovë (SIKTK),
 - 3) Zhvillimin e Gjeoportalit për Infrastrukturë Kombëtare të Informacioneve Hapësinore (IKIH).
 - 4) Është duke u koordinuar edhe përkrahja e USAID për përditësimin e Gjeoportalit ekzistues shtetëror dhe
 - 5) Implementimin e Planit të Veprimit për Informim Publik.
- ✓ Pjesëmarrje në Punëtorinë e 4-të Ndërkombëtare për Kualitetin e të Dhënave Hapësinore organizuar nga EuroGeographics, etj.